



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Sigurinë Kombëtare***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 13.11.2023, ora 14:00 (*online*)

**Drejton mbledhjen:**

**Nasip Naço – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Seancë dëgjimore me Shërbimin Informativ të Shtetit për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2024”.

**Marrin pjesë:**

Nasip Naço, Xhemal Qefalia, Antoneta Dhima, Bardhyl Kollçaku, Toni Gogu, Vullnet Sinaj, Pranvera Resulaj, Denis Deliu, Luan Duzha, Kasëm Mahmutaj, Bujar Çela, Dasantila Tahiraj dhe Arkend Balla.

**Mungojnë:**

Agron Çela, Ilirjan Pendavinji, Paulin Sterkaj, Lindita Metaliaj, Flamur Noka, Asllan Dogjani, Isuf Çelaj, Ervin Salianji, Enkelejd Alibeaj, Ferdinand Xhaferraj, Monika Kryemadhi dhe Lefter Gështenja.

**Të ftuar:**

Vlora Hyseni – drejtoreshë e Shërbimit Informativ të Shtetit

Kristaq Sterio – drejtor i Kabinetit në Shërbimin Informativ të Shtetit

Monika Plasa – drejtoreshë e Departamentit të Administrimit dhe Shërbimeve në Shërbimin Informativ të Shtetit

Gentian Opre – drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

## HAPET MBLEDHJA

**Nasip Naço** – Të nderuar kolegë,

Sot në rendin e ditës kemi seancë dëgjimore me Shërbimin Informativ të Shtetit në lidhje me projektligjin “Për buxhetin e vitit 2024”.

Të ftuar kemi zonjën Vlora Hyseni, drejtoreshë e Shërbimit Informativ të Shtetit. Faleminderit!

Zonja Hyseni, a më dëgjoni?

**Vlora Hyseni** – Po, i nderuar zoti kryetar, ju dëgjoj!

**Nasip Naço** – Kemi të ftuar edhe zotin Kristaq Sterio, drejtor i Kabinetit në Shërbimin Informativ të Shtetit, zonjën Monika Plasa, drejtoreshë e Departamentit të Administrimit dhe Shërbimeve.

Faleminderit!

Nga Ministria e Financave kemi zotin Gentian Opre.

Faleminderit që jeni prezent, zoti Opre!

Relator është zoti Kollçaku.

Fjala është për ju, zonja kryetare. Duke pasur parasysh se jemi në pamundësi për ta zhvilluar mbledhjen fizikisht, do ta zhvillojmë *online*. Nëse nga kolegët deputetë do të ketë pyetje, të cilat dalin jashtë objektit të kësaj dëgjese, që ka të bëjë vetëm me buxhetin, është në çmimin tuaj nëse do t’u ktheni përgjigje apo jo, duke vlerësuar maksimalisht çështjet që kanë të bëjnë me nivelet e klasifikimit të sekretit shtetëror.

Ju falënderoj për këtë lidhje!

Vazhdojmë me fjalën tuaj, zonja Hyseni.

Po përsëris edhe një herë për të gjithë kolegët deputetë se, nisur nga situata e sotme, duhet të bëni kërkesë për të aplikuar për certifikatë sigurie personale, pasi një pjesë e konsiderueshme, sidomos deputetët e opozitës, nuk janë pajisur me certifikatë sigurie. Do të doja që deputetët e opozitës të merrnin pjesë edhe në këtë diskutim *online*. Opozita nuk është vetëm fjalë, opozita është alternativë dhe duhet të japë opinionin e saj.

Fjala është për ju, zonja Hyseni!

**Vlora Hyseni** – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë të pranishëm në këtë video-takim,

Faleminderit, zoti kryetar! Sipas mundësive që na lejon ligji, duke u bazuar në faktin që Shërbimi Informativ i Shtetit ka kryesisht të dhëna që janë të klasifikuara, do të mundohemi

që, për shkak të rrethanave të situatës së krijuar, t'i paraqesim në formë të përmbledhur çështjet buxhetore të Shërbimit për vitin 2023 dhe për vitin 2024.

Të nderuar deputetë, për vitin 2024 Shërbimi Informativ i Shtetit ka përgatitur kërkesa buxhetore në përputhje me objektivat e politikës së programit nr. 03/520 “Veprimtaria informative shtetërore, si pjesë e projektbuxhetit afatmesëm 2024-2026”.

Në kuadër të miratimit të projektbuxhetit të vitit 2024, paraprakisht ju paraqesim një informacion të shkurtër për situatën financiare për vitin 2023. Për këtë vit fondi i akorduar me ndryshime është 1,8 miliardë lekë, ndërsa realizimi i deritanishëm është 1,52 miliardë lekë ose 84% . Deri në fund të vitit realizimi i buxhetit parashikohet të jetë në masën 98%.

Në projektbuxhetin e vitit 2024 për SHISH-in është parashikuar një fond në shpenzimet e përgjithshme në shumën 2,1 miliardë lekë ose 10,5% më shumë se viti 2023, duke plotësuar kërkesat e SHISH-it për financimin e politikave të institucionit. Në kuadër të vizionit për ristrukturimin, transformimin, modernizmin dhe profesionalizmin e institucionit, parashikojmë kërkesa të vazhduara për rritjen e buxhetit për arritjen objektivave.

SHISH-i, në funksion të mbajtjes së angazhimeve për plotësimin me sukses të objektivave për vitin 2024, ku mjedisi i sigurisë është në ndryshim të vazhdueshëm, paraqitet me një plan shpenzimesh për politikën ekzistuese në shumën 2,1 miliardë lekë, sa tavani i miratuar.

Të nderuar deputetë, detajet e raportit të buxhetit të SHISH-it i kemi dorëzuar me shkresën me nr. protokollin 4896, datë 06.11.2023.

I nderuar zoti kryetar, faleminderit për mundësinë!

Faleminderit, të nderuar deputetë!

**Nasip Naço** – Faleminderit, zonja Hyseni!

Ashtu siç e thatë edhe ju, në komision keni sjellë një raport në lidhje me kërkesat dhe sugjerimet tuaja në lidhje me projektbuxhetin. Vetëm deputetët që janë të pajisur me certifikatë sigurie, kanë të drejtë që ta lexojnë këtë raport.

Fjalën e ka zoti Kollçaku, si relator në lidhje me projektbuxhetin.

Zoti Kollçaku, do të doja ta shikonim në një këndvështrim tjetër, jo të përsërisni të njëjtat gjëra që janë në raport, këtë e them bazuar në eksperiencën në detyrat që keni pasur, por edhe si deputet.

Fjala është për ju, zoti Kollçaku.

**Bardhyl Kollçaku** – Në rregull.

E falënderoj drejtoreshën e Shërbimit për prezantimin saj, edhe pse i përmbledhur dhe i shkurtuar, për arsye të kësaj mbledhjeje të pazakontë. Ashtu siç e tha edhe kryetari i

komisionit, dëgjesat për buxhetin janë veprimtaritë më të rëndësishme për çdo komision, kështu që do të kishim dëshirë që këtë mbledhje ta zhvillojmë ashtu siç i ka hije këtij komisioni dhe institucionit që është thirrur sot. Të gjithë shqiptarët, që na dëgjojnë, e kanë të qartë tani se kush është interesuar që ky aktivitet kaq i rëndësishëm për një institucion kaq të rëndësishëm të mos zhvillohet sipas kërkesave të Rregullores. Kështu që në kushtet e kufizuara që kemi, për shkak se rrjeti që po flasim është i paklasifikuar, edhe informacioni do të jetë i përgjithshëm.

Së pari, dua t'i falënderoj të gjithë anëtarët e Shërbimit Informativ të Shtetit dhe drejtuesit për punën e palodhur, të heshtur që kanë bërë për t'i realizuar të gjitha detyrat dhe prioritetet e ngarkuara nga ligji, prioritete që në kohën dhe momentet që kalojmë e bëjnë akoma më të rëndësishme veprimtarinë e këtij Shërbimi. Shqipëria, si vend anëtar i NATO-s dhe një vend aspirant në BE, ka një politikë tepër të qartë jo vetëm kombëtare, por edhe rajonale për të kontribuar për një rajon të qetë dhe të sigurt, për një rajon paqësor. Të gjithë jemi dëshmitarë që koha ku jetojmë, ka nxjerrë në pah kërcënime dhe rreziqe të shtuara, qofshin tradicionale, veprimtari të dhunshme, terroriste, veprimtari sabotuese, veprimtari të luftës kibernetike. Prej gati dy vjetësh bota, natyrisht edhe ne si vend i NATO-s, po përjetojmë një agresion të paligjshëm, të pajustificuar të Rusisë ndaj Ukrainës dhe jemi dëshmitarë në muajt e fundit të një aktiviteti të ngjeshur dhe terrorist edhe në Lindjen e Mesme. Të gjitha këto kërcënime dhe rreziqe, të pleksura edhe me problematikat që sjellin kërcënimet e brendshme, qoftë krimi i organizuar apo korrupsioni, natyrisht që kërkojnë vëmendjen e Shërbimit Informativ të Shtetit. Kështu që jam i sigurt që janë në vëmendjen dhe në prioritetet e drejtuesve të SHISH-it për vitin 2024, por që të realizohen këto prioritetet, natyrisht që kërkohet edhe mbështetje buxhetore.

Më vjen mirë, siç e preku edhe në prezantimin e saj drejtuesja e SHISH-it, që realizimi i pritshëm i buxhetit të alokuar për vitin 2023 parashikohet të jetë 95%. Do të dëshiroja që të ishte 100%, pse jo, megjithatë mendoj se po të kishim një diskutim *face to face*, do të kishim edhe arsyet këtij mosrealizimi, por uroj dhe shpresoj që buxheti i alokuar për vitin 2024, i cili, me thënë të drejtën, ka një rritje mbi 10% në krahasim me buxhetin e vitit 2023, të shkojë në ato prioritetet dhe në ato drejtime që realizojnë më mirë objektivat kombëtare të sigurisë, jo vetëm të brendshme, por edhe të jashtme.

Më vjen mirë që një nga prioritetet kryesore është lartësimi i figurës së punonjësve të SHISH-it nëpërmjet një shpërblimi dhe një pagese më të mirë. Mendoj se në kushtet që jemi sot nga drejtuesja e SHISH-it, por edhe nga qeveria duhet të rimendohet, ndoshta me ndryshimet buxhetore që do të ndodhin gjatë mesit të vitit 2024, një trajtim më dinjitoz të punonjësve të SHISH-it, sepse e meritojnë, janë heronj të heshtur. Ne kujtohem për punonjësit

e SHISH-it vetëm kur ndodh ndonjë gjë, por, sa herë që situatat janë nën kontroll dhe është qetësi, harrojmë që pas atyre sukseseve janë punonjësit e inteligjencës, punonjësit e sigurisë, ndaj mbështetja e qeverisë dhe mbështetja jonë në këtë drejtim duhet të jetë e pakursyer.

Ne, zoti kryetar, ishim në Bizë dhe i pamë veprimet e Forcave Speciale Shqiptare dhe ato të rajonit, por, pa një inteligjencë profesionale, pa një inteligjencë të saktë dhe në kohë, nuk mund të ketë veprime të sakta as të Forcave Speciale apo atyre konvencionale.

Për sa u përket investimeve, kemi një rritje prej 6% për vitin 2024: një pjesë shkojnë për infrastrukturën, një pjesë shkojnë për pajisjet speciale. Nuk e kërkoj përgjigjen nga drejtuesja e SHISH-it, por dua të them se ne kemi edhe bashkëpunim me partnerët tanë strategjikë, të cilat mendoj se ndoshta nuk përfshihen në këtë buxhet, për të rritur dhe për të përforcuar kapacitetet tona operationale të operatorëve dhe punonjësve të e inteligjencës. Jam i sigurt që me këtë buxhet realizohen detyrat dhe objektivat që ka vënë drejtuesja e SHISH-it për vitin 2024, por duhet të kemi në vëmendje atë që thashë në fillim, ndryshime të mundshme të nivelit të pagave, për vështirësi dhe aspekte të tjera, për ta motivuar akoma më mirë personelin e agjencisë së inteligjencës, të SHISH-it në vitin në vazhdim, por edhe në perspektivë.

Edhe një herë, ju uroj suksese dhe i ftoj të gjithë kolegët e Komisionit të Sigurisë ta miratojmë projektbuxhetin për Shërbimin Informativ 2024.

Faleminderit!

**Nasip Naço** – Faleminderit, zoti Kollçaku!

Pa dashur t'u mbivendosem fjalëve tuaja, sugjeroj që ta ndajmë seancën e pyetjeve nga ajo e diskutimeve që mund të kenë kolegët.

Për të bërë pyetje e kanë kërkuar fjalën zonja Resulaj, zonja Dhima dhe zoti Deliu. Nëse ka kolegë të tjerë, të më thotë.

Zonja Resulaj, fjala për ju për të bërë pyetje për buxhetin.

**Pranvera Resulaj** – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Hyseni, për prezantimin tuaj dhe, mbi të gjitha, respekt për drejtues të institucioneve të tilla, të një rëndësie të veçantë!

Pyetjen për buxhetin e kam më shumë në nivelin makro, nuk dua të futem në detaje. Dua të di, e nderuar, në kohën që ju jeni në drejtim të këtij institucioni të rëndësishëm, ku konstatojmë se ka më tepër nevojë për mbështetje buxhetore tek investimet infrastrukturore logjistike apo te burimet njerëzore, ku përfshihen kualifikime, trajnime të personelit. Ky 10% që ju e thatë se keni marrë si rritje në fondin buxhetor për institucionin, krahasuar me vitin 2023, ku shkon kryesisht, pra cilin nga këto elemente që unë përmenda, prek?

Faleminderit! Ju uroj edhe një herë suksese!

**Nasip Naço** – Faleminderit, zonja Resulaj!

Zonja Hyseni, fjala është për ju.

**Vlora Hyseni** – Faleminderit!

Realisht kemi planifikuar investime në infrastrukturën e shërbimit. Më vjen keq që nuk patëm mundësi të raportojmë në detaje në lidhje me planifikimet dhe investimet që kemi planifikuar t'i realizojmë në vitin 2024. Kemi planifikuar investime në infrastrukturë, logjistikë dhe burime njerëzore, por kjo rritje 10% kemi planifikuar të shkojë për rritjen e pagave të zyrtarëve të shërbimit.

**Nasip Naço** – Faleminderit, zonja Hyseni!

Zonja Dhima, fjala është për ju.

**Antoneta Dhima** – Faleminderit, zoti kryetar!

E falënderoj zonjën Hyseni për relatimin e buxhetit të Shërbimit Informativ Shtetëror për vitin 2024!

Edhe pse në kushte jonormale, ne do të vazhdojmë diskutimin e buxhetit për pjesën që nuk përbën sekret shtetëror. Unë do të bëj disa pyetje në lidhje me buxhetin.

Së par, si paraqitet realizimi i investimeve të pritshme për vitin 2023?

Së dyti, si e vlerësoni ju nivelin e pagave të punonjësve të Shërbimit Informativ Shtetëror, krahasuar me institucionet e tjera të administratës publike?

Së treti, me buxhetin e akorduar nga ana e qeveris për vitin 2024, a mendoni që do t'i realizoni misionin dhe përgjegjësitë e institucionit tuaj?

Së fundi, mbase nga ana e relatorit u theksua ose u cek pak kjo gjë, por doja të dija, a keni parashikuar në buxhetin vitit 2024 investime të tjera me burime të huaja nga partnerë ose nga donatorë të ndryshëm, me të cilët ju bashkëpunoni?

Për sa i përket nivelit të pagës dhe shpërblimit të punonjësve, a keni kërkuar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që të rishikohen pagat e institucionit tuaj, pasi kjo është edhe një nga politikat e qeverisë për t'i rritur vit pas viti pagat e punonjësve të administratës shtetërore?

Faleminderit!

Urime dhe suksese!

Më vjen keq që për herë të dytë nuk na krijohet mundësia që drejtuesen e Shërbimit Informativ Shtetëror ta kemi pranë komisionit për të ndarë probleme dhe problematika përtej informacionit të sotëm.

Faleminderit!

**Nasip Naço** – Faleminderit, zonja Dhima!

Zonja Hyseni, fjala është për ju.

**Vlora Hyseni** – Faleminderit!

Investimet për vitin 2023, siç e cekta, deri tani janë realizuar 84%, kurse deri në fund të vitit realizimi i investimeve planifikohet të jetë në masën 98%.

Për sa i përket çështjes së pagave, gjithashtu, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në vitin 2023, niveli i rritjes së pagave në SHISH, krahasimisht me nivelin e pagave të institucioneve të tjera, është më i ulët. Në këto kushte, SHISH-i po punon duke pasur në konsideratë natyrën e veçantë të stafit të Shërbimit. Gjithashtu, jemi angazhuar dhe kemi zhvilluar disa takime me ministrin e Financave, si dhe po punojmë që në vitin 2024 të krijojmë politika të rritjes së pagave për zyrtarët e Shërbimit. Kemi një përkrahje të jashtëzakonshme nga Ministria e Financave për të gjetur mënyrën për të rritur pagat.

Për sa i përket pyetjes suaj, e nderuar deputete, lidhur me investimet shtesë në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë të Shërbimit, këto informacione nuk mund t'i japim përmes një rrjeti të paklasifikuar. Do të doja shumë të isha në kushte të tjera dhe t'ju jepja detaje për sa i përket bashkëpunimi tonë me partnerët, sa u përket investimeve të tjera lidhur me infrastrukturën, lidhur me rrjetet e klasifikuara, lidhur me trajnimet e zyrtarëve të Shërbimit, lidhur me objektivat e përbashkëta që kemi, por me siguri do të bashkëbisedojmë ndonjë rast tjetër për këtë pyetje që sapo parashtruat.

Faleminderit!

**Nasip Naço** – Faleminderit, zonja Hyseni!

Zoti Deliu ka pyetje dhe më pas fjalën do ta marrë zoti Çela.

**Denis Deliu** – Faleminderit, kryetar!

Do të doja shumë që kjo mbledhje të bëhej me dyer të mbyllura dhe të diskutonim së bashku, por në pamundësi, unë kam dy pyetje, që besoj se nuk janë sekret për SHISH-in.

Pyetja e parë është: a ka planifikuar SHISH-i ta ndryshojë vështirësinë për natyrë të veçantë pune?

Te benefitet për punonjësit e SHISH-it, a është menduar që në buxhetin e këtij viti të ketë edhe një kredi të butë për punonjësit që nuk kanë shtëpi?

Pyetja e dytë: duke qenë se një nga sfidat më të mëdha të kohës, që ka prekur edhe SHISH-in, a është planifikuar në buxhetin e këtij viti mbrojtja dhe siguria kibernetike?

Për ta mbyllur, pasi e kuptoj natyrën e veçantë të shërbimit, sfidat e reja kërkojnë një bashkëpunim sa më të madh me strukturat e tjera, dhe, duke pasur besim te drejtoresha e re, shpresoj që ne ta shohim SHISH-in në një nivel tjetër!

Ju faleminderit, dhe ju uroj suksese në punën tuaj!

**Nasip Naço** – Faleminderit, zoti Deliu, për pyetjet tejet profesionale!

Fjala për ju, zonja Hyseni.

**Vlora Hyseni** – Faleminderit!

Lidhur me pyetjen e parë, ne jemi në fazën e draftimit të akteve të brendshme ligjore, me të cilat do të parashikojmë mbështetje, sidomos për stafin e SHISH-it që është i angazhuar në pjesën e operacioneve. Ne kemi planifikuar të krijojmë mbështetje të veçantë, që do të thotë rritje të përfitimeve për aktivitetin e tyre, pra rritje të mbështetjes për punën e zyrtarëve dhe punonjësve të SHISH-it në secilën prej kategorive që janë të angazhuar dhe, sipas angazhimit dhe rrezikshmërisë në projekte, do të parashikohet mbështetje e veçantë për ta.

Sa i përket pyetjes për mbrojtjen dhe sigurinë kibernetike, kjo është një ndër prioritetet e Shërbimit, që realisht në rrethana të tilla nuk kemi mundësi të japim informacion shtesë, por nëse do të ishim në një takim fizik, që unë mezi e pres, do të flisja më tepër për projektin që ka SHISH-i sa u përket investimeve për sigurinë e rrjetit të klasifikuar dhe atij të paklasifikuar të Shërbimit.

Një pjesë e buxhetit për vitin 2024 është planifikuar të investohet në rrjet dhe siguri kibernetike.

Sa i përket pyetjes për bashkëpunimin me institucionet e tjera, ne realisht kemi një bashkëpunim të ngushtë me të gjitha institucionet e Republikës së Shqipërisë.

Faleminderit!

**Nasip Naço** – Faleminderit, zonja Hyseni!

Zoti Çela, më dëgjoni? Fjala për ju.

**Bujar Çela** – Përshëndetje!

Ne po diskutojmë ligjin më të rëndësishëm të një viti kalendarik, buxhetin e shtetit, pa të cilin nuk mund të funksionojë asnjë strukturë. SHISH-i, si një strukturë e rëndësishme së veçantë, ka shumë arsye të jetë më i mbështetur, për vetë faktin që kryetarja nuk është thjesht kryetare e SHISH-it, por është kryetarja shqipfolëse e të gjithë trevave ku ka shqiptarë. Ne jemi i vetmi vend anëtar i NATO-s, ku të gjitha vendet shqipfolëse rreth e qark kanë nevojë për këtë ndërlidhje...

Nuk ju dëgjoj!

**Nasip Naço** – Zoti Çela, më dëgjoni?

Do të doja të bënit pyetje, dhe, pasi të ezaurojmë këtë pjesë, do të fillojmë me diskutimet. Nuk kam asgjë me komentet tuaja, e kam vetëm për procedurë.

**Bujar Çela** – Dakord.



Ky është një komision i rëndësishëm së veçantë dhe në takime të tilla, *online*, edhe jemi vetëm ne, edhe nuk jemi vetëm ne. Ky buxhet, i alokuar për SHISH-in, pavarësisht se është më i lartë se ai i vitit 2023, për vetë sfidat që ka ky vit dhe viti që vjen, si pasojë e luftërave dhe nga gjendja e të gjithë sigurisë në Ballkan, mendoj se nuk do të mund t'i plotësojë nevojat për të realizuar detyrat e të rëndësishme të kësaj strukture.

**Nasip Naço** – Faleminderit, zoti Çela!

Fjala për zonjën Hyseni.

**Vlora Hyseni** – Faleminderit, zoti deputet!

Për shkak se ne kemi vlerësuar që buxheti i aktual i planifikuar për Shërbimin nuk i plotëson nevojat e tij, ne kemi dërguar projekte shtesë dhe do të...

**Bujar Çela** – Kemi të bëjmë me një organ të rëndësishëm së veçantë.

**Vlora Hyseni** – Unë kam folur me ekipin tim që të realizojmë projekte.

Unë e kuptoj edhe Ministrinë e Financave, që, në mungesë të vizionit, në mungesë të realizimit të buxhetit, nuk ka pasur mundësi që PBA-në apo tavanin buxhetor ta rritë për Shërbimin.

Ne bashkë me ekipin, kolegët në Shërbim, kemi punuar që ta realizojmë buxhetin që kemi pasur në dispozicion, të krijojmë projekte shtesë sa i përket infrastrukturës, modernizimit, transformimit, profesionalizimit të Shërbimit, për të cilat do të kërkojmë shtesë buxheti në vijim, me qëllim realizimin e projekteve dhe arritjen e objektivave të Shërbimit.

Faleminderit!

**Nasip Naço** – Faleminderit, zonja Hyseni!

Zoti Sinaj dhe zoti Duzhaj, keni pyetje, që të kalojmë në diskutime?

**Vullnet Sinaj** - Kryetar, nuk kam ndonjë pyetje.

Më vjen keq që mbledhja që nisëm për ta bërë te zyra e Komisionit të Sigurisë, nuk u realizua siç duhet!

Dua t'i uroj suksese drejtueses së SHISH-it!

**Nasip Naço** – Faleminderit!

Zoti Duzha, fjala për ju.

Më dëgjoni?

Të nderuar kolegë, meqenëse nuk ka më pyetje, do të doja t'u përmbahemi diskutimeve në lidhje me buxhetin.

Zonja Dhima, fjala për ju.

**Antoneta Dhima** – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, ne si Komision i Sigurisë Kombëtare pjesën e diskutimit të buxhetit që na takon, e zhvilluam, ndërsa për gjërat e rëndësishme, që ne s'mund t'i flasim *online*, shpresoj të krijojmë mundësinë që zonja Hyseni ta jetë prezente në Komisionin e Sigurisë Kombëtare, ku ta informojë komisionin për të gjitha problematikat dhe veprimtarinë e këtij institucioni shumë të rëndësishëm të sigurisë kombëtare.

Unë i uroj sërish suksese, zonjës Hyseni!

Ndiej keqardhje që opozita nuk është pranë këtij komisioni për të zhvilluar një seancë shumë të rëndësishme, që është diskutimi i buxhetit për Shërbimin Informativ Shtetëror!

Gjithsesi, strukturat atje janë duke punuar, me në krye drejtuesen e këtij institucioni dhe, pavarësisht se opozita nuk bie dakord, ne do të vazhdojmë punën në komision për shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit jo vetëm të SHISH-it, por të të gjitha institucioneve që raportojnë pranë Komisionit të Sigurisë Kombëtare, si: të Ministrisë së Brendshme, të Ministrisë së Mbrojtjes, të Gardës së Republikës dhe të shërbimeve të tjera të rëndësishme të veçantë.

Faleminderit, zoti kryetar!

**Nasip Naço** – Faleminderit, zonja Dhima!

Zoti Çela, keni diçka për diskutim?

**Bujar Çela** – Dikur kemi parë një film: “Nuk bëhet shaka me miellin e gjermanit”. SHISH-i është një strukturë shumë e rëndësishme dhe buxheti i kësaj qeverie në lidhje me këtë organ kaq të rëndësishëm nuk duhet të kishte asnjë tolerancë, sepse varësia financiare të çon në disa varësi të tjera, të cilat i dëmtojnë të gjithë.

Unë shpresoj dhe besoj fort që ky organ ka detyra shumë të rëndësishme, të padukshme, por që janë themeli dhe palca në të cilën qëndron organizmi ynë. Me njohjet që kemi, kudo hasim punonjës, por pa financa. Gjej rastin t'u bëj thirrje Ministrisë së Financave dhe qeverisë që ta rishikojë buxhetin, sepse ka ende kohë, me qëllim që mangësitë financiare për këtë strukturë të plotësohen në mënyrë emergjente. Koha dëshmon një urgjencë, e cila nuk duhet të diskutohet për çështje buxhetore, sepse SHISH-i është një institucion i një rëndësie me të vërtetë të veçantë. Të gjitha strukturat e tjera mund të presin, por struktura e SHISH-it s'mund të presë, sepse dëmi për shkak të neglizhencës do të jetë shumë i madh.

E përmenda edhe në fillim në pyetjen që bëra ( zakonisht pyetje bën nxënësi që e ka lexuar mësimin) unë kam besim të plotë te kryetarja në drejtimin e një institucioni me një rëndësi të veçantë, e cila ka një njohje Kosovë-Shqipëri, që nuk mund të jenë dot dy shtete, sepse janë vetëm fizikisht të ndara, por kanë marrëdhënie shumë të rëndësishme dhe të dy kufijtë nuk mund të bëjnë dot pa njëri-tjetrin.

Faleminderit!

**Nasip Naço** – Faleminderit, zoti Çela, për sensibilizimin dhe ndjeshmërinë që keni për këtë shërbim!

Si deputet me eksperiencë, ju mund të bëni një amendament për të plotësuar të gjithë atë sensibilizim që keni ndaj këtij shërbimi.

Zoti Kollçaku, keni fjalën.

**Bardhyl Kollçaku** – Zoti kryetar, për t'i rënë shkurt, pasi problemet kryesore ...

**Nasip Naço** – Duke qenë se nuk ka diskutime të tjera dhe ju jeni relator, do të doja ta mbyllja me ju.

**Bardhyl Kollçaku** – ... drejtueses së SHISH-it, por edhe të gjithë punonjësve të këtij institucioni kaq të rëndësishëm: suksese në punën e tyre! Kur të kemi dëgjesën e radhës do t'i shikojmë kërkesat që nuk plotësohen nga ky buxhet, por edhe gjatë vitit 2024, kur të bëhen rialokimet dhe rishikimi i buxhetit, do të kemi mundësinë t'i plotësojmë.

Palca ose pjesa kryesore e këtij shërbimi janë njerëzit dhe motivimi i tyre nëpërmjet pagesave të mira dhe mbështetjes financiare qoftë për strehim, qoftë për pajisje apo edhe mbështetja për të kryer detyrën, janë garanci që kërcënimet dhe rreziqet e shtuara të sigurisë do të përballohen. Shqipëria do të jetë jo vetëm një vend i sigurt për të gjithë shqiptarët dhe për të gjithë kombin shqiptar, por edhe kontribuuese reale për sigurinë jo vetëm në rajon, por edhe për NATO-n, BE-në dhe strukturat e tjera të sigurisë.

Faleminderit!

**Nasip Naço** – Faleminderit, zoti Kollçaku!

Faleminderit, të nderuar kolegë!

Besoj se votimi në parim i buxheti i vitit 2024 do të jetë në datat 20-21 dhe në datën 7 dhjetor do të bëhet miratimi i buxhetit nen për nen, që është shumë i rëndësishëm. Besoj se midis këtyre datave Komisioni i Sigurisë Kombëtare në takimet e ngushta me SHISH-in (të gjithë deputetët që kanë certifikatë sigurie) do ta dëgjojë nga afër që, në përfundim të kësaj, të mundësojmë shtimin e fondeve, aq sa ka mundësi ky komision, për t'ia sugjeruar më pas Komisionit të Ekonomisë. Duke qenë se jemi *online*, nuk do të donim të kishim një vlerë *online* nga drejtorja e SHISH-it, por në takimin që do të bëjmë të gjitha shqetësimet do t'ia rekomandojmë Komisionit të Ekonomisë. Pa dyshim, të gjithë kolegët deputetë, qoftë edhe të opozitës, më vjen keq që nuk janë sot, e kemi mbështetur dhe do ta mbështesim pa kushte SHISH-in, pasi është një shërbim i vlefshëm për ne, për të ardhmen e vendit tonë dhe për të ardhmen e fëmijëve tanë.

Në përfundim, falënderoj zonjën drejtore së bashku me kolegët!

Besoj se vota juaj do të jetë pro buxhetit të vitit 2024.

Faleminderit, zonja Hyseni!

Faleminderit, kolegë deputetë!

E mbyllim këtë dëgjesë *online* për buxhetin e SHISH-it.

**Vlora Hyseni** – Faleminderit, i nderuar kryetar!

Ju e përmendët, unë, si drejtore e SHISH-it bashkë me kolegët e mi jemi të angazhuar në mbrojtjen e sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë. Vizioni ynë është orientimi i shërbimit në një drejtim të caktuar drejt modernizimit, profesionalizimit dhe ngritjes së infrastrukturës së SHISH-it.

Pavarësisht përkatësive politike, pozitë-opozitë, të gjithë jeni të mirëpritur dhe besoj se të gjithë do ta na mbështesin në një rrugë të tillë, sepse një investim i tillë është për sigurinë kombëtare të Shqipërisë, është për sigurinë e të gjithë shqiptarëve.

Në asnjë rrethanë nuk ka të bëjë aspak pozita apo opozita, por ka të bëjë me interesat kombëtare të Shqipërisë. Shpresoj dhe besoj që i gjithë Komisioni për Sigurinë Kombëtare do të na mbështesë dhe do të jetë bashkëpunues, sikurse edhe unë do të jem bashkëpunuese me të gjithë, pavarësisht se cilit krah politik i përkasim, me qëllim arritjen e objektivave dhe ndërtimin e shërbimit, që të jetë një nga shërbimet më moderne dhe më profesionale në rajon. Një gjë e tillë besoj se na takon, pasi jemi edhe anëtar të NATO-s dhe pretendentë si shtet për t'iu bashkuar BE-së. Ju faleminderit, për mbështetjen! Besoj se do ta kem mbështetjen e të gjithë deputetëve, që janë anëtarë të këtij komisioni. Unë do të jem bashkëpunuese dhe do të mirëpres çfarëdo pyetje apo interesimi që ata kanë për diskutim. Do të jemi të hapur me të gjithë deputetët që kanë certifikatë sigurie dhe ju intereson mbarëvajtja e punës së shërbimit. Herën tjetër do të kemi mundësi të flasim hapur me të gjithë deputetët e këtij komisioni, të cilët janë të interesuar të dinë më tepër se në çfarë drejtimi po shkon SHISH-i.

Faleminderit, kryetar!

**Nasip Naço** – Faleminderit!

Të nderuar kolegë, këtu e mbyllim seancën e sotme.

**MBYLLET MBLEDHJA**